


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SH.A. "TRAJTIMI I STUDENTËVE NR.1" TIRANË.
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr 3, dt. 7.12.2005.

Verifikohet origjinali me origjinalin
877-Post
04.8.12.05



Këshilli mbikëqyrës i sh.a. "Trajtimi i Studentëve Nr.1" Tiranë, i mbledhur në datën 7.12.2005, në zbatim të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë trgtare", neni 98, si dhe të ligjit 7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", i ndryshuar, si dhe VKM nr. 133, datë 13.04.2002 "Për disa ndryshime në vendimin nr.317, datë 08.07.1999, të Këshillit të Ministrave "Për shpërblimin e punës së punonjësve", ndryshuar me vendimet nr.261, datë 25.05.2000 dhe nr.36, datë 20.01.2001.",

Vendosi:

1. Emërimin në postin e drejtorit të sh.a "Trajtimi i Studentëve Nr.1" Tiranë, Z.Bujar Brovina.
2. Paga e drejtorit të jetë në masën 85,000 leke.


KËSHILLI MBIKËQYRËS

Anila Jani




Tiranë më. 7.12.2005

Kledia Mazniku



Teuta Starova.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI MBIKQYRES
SH.A "TRAJTIMI I STUDENTEVE NR.1" TIRANE

VENDIM

Nr. 2, date 20.09.2013

Këshilli Mbikëqyrës i sh.a "Trajtimi i Studenteve Nr 1" Tirane, ne zbatim te Vendimit te Këshillit te Ministrave Nr.642, date 11.10.2005 " Për Këshillat Mbikëqyrëse te Shoqërive Anonime Shtetërore" , dhe Udhëzimit Nr.318 date 08.04.2009 " Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës ne Shoqëritë Anonime Shtetërore", ne mbledhjen e tij te datës 20.09.2013 ;

VENDOSI

1. Lirimin e Z. Bujar Brovina, nga detyra e Administratorit te Shoqërisë " Trajtimi i Studenteve Nr. 1" Tirane.
2. Marrëdhëniet financiare rregullohen sipas legjislacionit ne fuqi

Ky Vendim hyn ne fuqi menjëherë.

KESHILLI MBIKQYRES

ALKET HYSENI

KRYETAR

Alket Hyseni
[Signature]
2013

PLARENT NDRECA

ANETAR

Plarent Ndreca
[Signature]

ARBER LLESHI

ANETAR

Arber Lleshi
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI MBIKQYRES
SH.A "TRAJTIMI I STUDENTEVE NR.1" TIRANE

VENDIM

Nr. 3, date 20.09.2013

Këshilli Mbikëqyrës i sh.a "Trajtimi i Studenteve Nr 1" Tirane, ne zbatim te Vendimit te Këshillit te Ministrave Nr.642, date 11.10.2005 " Për Këshillat Mbikëqyrëse te Shoqërive Anonime Shtetërore" , dhe Udhëzimit Nr.318 date 08.04.2009 " Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës ne Shoqëritë Anonime Shtetërore" , ne mbledhjen e tij te datës 20.09.2013 ;

VENDOSI

1. Emerimin e Zj. Anila SHEHU, ne detyren e Administratorit te Shoqërisë " Trajtimi i Studenteve Nr. 1" Tirane.
2. Marrëdhëniet financiare rregullohen sipas legjislacionit ne fuqi

Ky Vendim hyn ne fuqi menjëherë.

KESHILLI MBIKQYRES

ALKET HYSENI

KRYETAR

Alket Hyse ni
20
2013

PLARENT NDRECA

ANETAR

Plarent Ndreca
[Signature]

ARBER LLESHI

ANETAR

ARBER LLESHI
A. Lleshi



REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR.1 sh.a
KËSHILLI MBIKQYRËS

17.11. 2016

Nr.Prot. 992

Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë "Rezidenca Studentore Universitare Nr.1" sha, Tiranë, në zbatim të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", (i ndryshuar), VKM Nr.335, datë 04.05.2016, për "Transferimin e 100% të aksioneve të shoqërive aksionere "Rezidenca Studentore nr. 1" sha, Tiranë, "Trajtimi i Studentëve nr. 2" sha, Tiranë dhe "Trajtimi i Studentëve nr. 3" sha, Tiranë, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të Bashkia Tiranë", Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015, nenit 64 shkronja "f" për "Vetqeverisjen vendore", VKM Nr. 642, datë 11.10.2005, "Për Këshillat mbikqyrës të shoqërive anonime shtetërore", sidheVendimi Nr 27004 datë 08.09.2016 në mbledhjen e tij të datës 07.10.2016,

V E N D O S I:

1. Emërimin e Zj. Anila Shehu, në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë "Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1"sh.a, Tiranë.
2. Miratimin e kërkesës për vendosjen e antenës nga Kompania Eagle Albtelecom kundrejt pagesës mujore në vlerën 50,000 ALL me T.V.SH.
3. Miratimin e pagesës së Sekretares së Këshillit Mbikqyrës në vlerën 5,000 ALL në muaj.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anuela Ristani
Kryetar

Plarent Ndreca
Anëtar

Ditjon Baboçi
Anëtar





REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHETËTËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

U R D H Ë R

Nr. 67 Datë 29/1 /2014

PËR

NDRYSHIM NË KËSHILLIN MBIKQYRËS

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995, Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare", i ndryshuar, dhe Vendimin Nr. 642, datë 11.10.2005 "Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore;

URDHËROJ:

1. Lirimin nga detyra të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës në sh.a "Trajtimi i Studentëve Nr.1" Tiranë:

- Z. Arbër LLESHI

2. Emërimin si anëtar në Këshillin Mbikëqyrës të sh.a "Trajtimi i Studentëve Nr.1" Tiranë:

Zj. Eda SPAHIU, Përfaqësuese e Ministrisë së Financave.

3. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistr.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISE DHE SIPERMARRJES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E PRONES SHTETERORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE PRONES PUBLIKE

URDHËR

Nr. 6486 Datë 20/8 /2015

PËR

LIRIMIN NGA KËSHILLI MBIKQYRËS

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995, Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare", i ndryshuar, dhe Vendimin Nr. 642, datë 11.10.2005 "Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore;

URDHËROJ:

1. Lirimin si anëtar të Këshillit Mbikëqyrës në sh.a "Rezidenca Universitare Nr.1" Tiranë:
 - Z. Alket HYSENI
2. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

SHKRUAR NË TIRANË
20/8/2015
[Signature]

MINISTRI
ARBEN AHMETAJ
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

REZIDENCA STUDENTORE
UNIVERSITARE NR.1 SH.A
Nr. 925 Prot.
Datë 18.09.2015

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Tel: ++35542200245; ++35542448021

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2015.

URDHËR

Nr. 678 Datë 7.9 /2015

PËR

EMËRIM NË KËSHILLIN MBIKQYRËS

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995, Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare", i ndryshuar, dhe Vendimin Nr. 642, datë 11.10.2005 "Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore;

URDHËROJ:

1. Emërimin si anëtar në Këshillin Mbikëqyrës të sh.a "Rezidenca Universitare Nr.1", Tiranë:

- Z. Alket HYSENI përfaqësues i MZHETTS.

2. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



MINISTRI
ARBEN AHMETAJ



BASHKIA E TIRANËS
KRYETARI

13.09.2016

Nr.Prot. 731

VENDIM

i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë
“Rezidenca Studentore Universitare Nr.1” sh.a.

Nr. 27009 datë 08.09 2016

REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR.1 SH.A. është një Shoqëri Aksionere, Shqiptare, e regjistruar rregullisht në Regjistrin Tregtar, me nr. NIPT K5184005N, me datë 11.06.2005, me një kapital prej 7.976.136.000,00 Leke e ndarë në 7.976.136,00 aksione me vlerë prej 1.000,00 Lekë secila, me aksionere Bashkinë e Tiranës mbi bazë të VKM NR.335, datë 04.05.2016, për “Transferimin e 100% të aksioneve të shoqërive aksionare "Rezidenca Studentore nr. 1" sha, Tiranë, "Trajtimi i Studentëve nr. 2" sha, Tiranë dhe "Trajtimi i Studentëve nr. 3" sha, Tiranë, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të Bashkia Tiranë”.

Sipas shkronjës “f” të nenit 64 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, për “Vetqeverisjen vendore” Kryetari i Bashkisë në cilësinë e autoritetit ka të drejtën për të emëruar anëtarët e organeve drejtuese të shoqërive tregtare në pronësi të Bashkisë dhe ka të drejtën e emërimit dhe shkarkimit të anëtareve të këshillit mbikqyrës.

Janë të pranishëm në mbledhje:

Kryetari i Bashkisë së Tiranë, në cilësinë e përfaqësuesit të aksionerit. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret dhe organizohet në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (i ndryshuar)

RENDI I DITËS:

Shkarkimin dhe Emërimin e kryetarit dhe të anëtareve të Këshillit mbikqyrës të shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare Nr.1”, sha.

Te tjera.

DUKE QENE SE:

Aksionerët janë njoftuar në mënyrë të rregullt në lidhje me Rendin e Ditës, dhe janë mbledhur me vullnetin e tyre në këtë Mbledhje për të diskutuar dhe për të vendosur më pas në lidhje me çështjet që ju janë adresuar atyre nëpërmjet këtij Vendimi të Asamblesë së Aksionerëve (“Vendimi”);

Aksioneri është duke vendosur mbi çështjet e specifikuara në kete Vendim, ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe çdo akt ne fuqi te Shoqerise. Kuorumi i kërkuar nga ligji dhe nga Statuti i Shoqërise është arritur ne menyre te vlefshme dhe Asambleja ka te drejte te vendose mbi pikat e Rendit te Ditës;

Aksioneri, permes nenshkrimit te ketij Vendimi, shpreh miratimin për daten e Mbledhjes dhe mbi çështjet të cilat do te miratohen nga ky Vendim.

PERFUNDIMISHT, U VENDOS:

1. Lirimin nga detyra e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës “Rezidenca Studentore Universitare Nr.1” sh.a, si më poshtë:

- Alket Hyseni
- Eda Spahiu

2. Emërimin si anëtarë të Këshillit Mbikqyrës Mbikqyrës “Rezidenca Studentore Universitare Nr.1” sh.a, si më poshtë:

- Anuela Ristani
- Plarent Ndreca
- Ditjon Baboçi

3. Ngarkohet Zj. Evisa Hoxhaj, Drejtor, Drejtoria Juridike pranë “Rezidenca Studentore Universitare Nr.1” sha, të kryejë veprimet mbi ndryshimet e bëra sipas këtij Vendimi pranë QKB.

Asnjë vendim tjetër nuk u mor në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionerëve, e cila u mbyll në orën 10:00.

Tiranë, më _____

Aksionerët

Bashkia Tiranë


Erion Veliaj

Kryetar





**BASHKIA
TIRANË**
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
KRYETARI



Nr. 42084 prot.

Tiranë, më 5, 11, 2019

Lënda: Përcjellim vendimin e emërimit të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë "Rezidenca Studentore Universitare nr. 1" sha.

ZONJËS ANILA SHEHU

SHOQËRIA "REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1" SHA

TIRANË

E nderuara zonja administratore,


Nenet 161, pika 2 dhe 167 pika 5, të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, kanë përcaktuar se këshilli mbikqyrës i shoqërive tregtare emërohet për një mandat me afat 3-vjeçar.

Duke qenë se referuar këtij afati, mandati i këshillit të mëparshëm ka përfunduar, si dhe në zbatim të parashikimeve të nenit 64, shkronja "f", të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, në të cilin përcaktohet se kryetari i Bashkisë vendos për emërimin ose shkarkimin e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërive tregtare tregtare në pronësi të bashkisë, si dhe drejtuesit e ndërmarrjeve e të institucioneve në varësi, duke qenë se mandati i bashkëlidhur po ju dërgojmë vendimin nr. 42084, datë 04.11.2019, "Për emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë "Rezidenca Studentore Universitare nr. 1" sha.

Ju faleminderit,

KRYETARI

Erion VELIAJ





BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
KRYETARI

VENDIM

Nr. 42084 datë 5.11 2019

**PËR
EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKQYRËS TË SHOQËRISË
“REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nenit 64 shkronjat “a” dhe “f”, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, vendimit nr. 335, datë 04.05.2016, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e 100% të aksioneve të shoqërive aksionare “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1” SHA, Tiranë, “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” SHA, Tiranë dhe “Trajtimi i Studentëve Nr. 3” SHA, Tiranë, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të Bashkia Tiranë”, nenit 6, pika 1, të statutit të shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare nr. 1”, sha,

VENDOS:

1. Emërimin e këshillit mbikqyrës të shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare nr. 1” sha, Tiranë, si më poshtë:
 - a. Zonja Anuela Ristani;
 - b. Zonja Sara Goxhaj;
 - c. Zoti Ditjon Baboçi.
2. Ngarkohet shoqëria “Rezidenca Studentore Universitare nr. 1” sha, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Erion VELIAJ



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
KRYETARI

URDHËR

Nr. 5421 datë 01.02 2019

PËR

“DELEGIM FIRME”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 15, neni 29, neni 99, pika 1 neni 104 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

URDHËROJ:

1. **Z. Arbjan Mazniku** me detyrë Nën/Kryetar i Bashkisë së Tiranës, të nënshkruajë në mungesë dhe me urdhër nën emrin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës.
2. Ky urdhër i shtrin efektet deri në datë 31.12.2019
3. Ngarkohet Kabineti i Kryetarit të Bashkisë së Tiranës për zbatimin e këtij urdhri.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Erion Veliaj

